



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN**

PROCESVERBAL

**në mbledhja e II-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
11 shkurt 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloj në ora 13:45.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu theksoi se ka ardhur një pikë për t'u futur në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – pyeti se kjo pikë shtesë që ka ardhur a është shumë urgjente?

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se mund të kemi vërvshime përsëri, pasi se banorët e Lumit të Madh më kanë njoftuar se janë të rrezikuar nga uji. Ai kërkoi nga organet kompetente që të ndërmarrin masa për t'i shpëtuar ato ekonomi familjare që janë të rrezikuara.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së – lidhur me Draft-Statutin e Qendrës për Punë Sociale, drejtori i Qendrës për Punë Sociale, Rrahim Ajeti më ka kontaktuar edhe mua dhe sekretarinë dhe tha që e kemi si prioritet aprovimit e statutit, pasi që jemi vonuar për një gjë të tillë. Ai tha që brenda mundësive të procedohet. I thashë që mund ta dërgojmë në KPF dhe anëtarët e KPF-së vendosin për ta proceduar apo jo në kuvend.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se pasi që kemi pak pikë për shqyrtim, ndoshta do të ishte mirë të bëjmë përjashtim, ta shqyrtojmë dhe ta procedojmë në kuvend.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – u shpreh se në parim jemi dakorduar që të gjitha pikat që vijnë për kuvend, të vijnë edhe në KPF. Por, ne e patëm rastin nga mbledhja e kaluar, ku Plani për Rimëkëmbje nuk na ka ardhur fare në KPF, por edhe për kuvend ka ardhur me vonesë. Prandaj, kur bëhet përjashtime në disa raste, ndoshta është mirë që edhe në këtë rast të bëjmë përjashtim edhe pse ka ardhur pak me vonesë. Prandaj, nëse janë kryer procedurat ligjore, jam që ta fusim në rend të ditës dhe ta procedojmë në kuvend.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e KPF-së – deklaroi se ky nuk është një dokument i thjeshtë që të vjen kaq shpejt. Ajo tha se e ka lexuar, por jo edhe analizuar. Prandaj, nuk jam e gatshme që të diskutojë sot për këtë. Jam që ta shtyjmë për mbledhjen e radhës, tha ajo.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se ky dokument është i kopjuar nga një komunë dhe vetëm po ja ndërrojnë emrin e qytetit. Mirë është që ta shtyjmë dhe të bëhet një statut i mirë. Ai tha se jemi pajtuar në KPF që dokumentet të cilat janë shumë urgjente do t'i përkrahim.

Komiteti për Politikë dhe Financa me pesë (5) vota “për” dhe tri (3) “kundër” vendosi që mos ta fus në rend të ditës <Shqyrtimin e Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale>.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 janar 2021;
 2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lejimin e pagesës së mjeteve financiare për KEDS-in;
 3. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2020;
 4. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020;
 5. Të ndryshme.
-
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 janar 2021.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 14 janar 2021.

2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lejimin e pagesës së mjeteve financiare për KEDS-in.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – paraqiti si shqetësim mosprezencën në mbledhje të drejtoreve të drejtive për të dhënë sqarime eventuale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2020.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se mirë që u lirua për qarkullim rruga magjistrale, pasi që janë shkaktuar shumë aksidente në këtë rrugë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Informatës për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – Në këtë informatë nuk flitet fare për qentë endacakë. Ai pyeti se çka po ndodhë me qentë endacakë? Gjendja është përkeqësuar dhe po paraqet shqetësim për qytetarët. Ky është një problem në tërë Kosovën dhe se nuk e fajësoj komunën, sepse komuna nuk mund ta kryej këtë problem. Qeveria e Kosovës duhet të merret më seriozisht me këtë dukuri.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Të ndryshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se punëtorëve teknikë të tri shkollave të mesme, nuk iu kanë dhënë pagat e plota. Ai kërkoi nga Drejtoria për Arsim një informatë se pse nuk iu kanë paguar pagat e plota këtyre punëtorëve?

Mbledhja përfundoi në orën **14:10**.

Bujar Klinaku
B.Klinaku
Procesmbajtës



Nasuf Aliu
Kryesues i KK-së dhe i KPF-së